

**Burimet:** deklarata G.B, FDH-17961; *Three Albanians Killed During Serb Attacks near Zlokucan, Klina*, pasqyra e lajmeve, KIC, 9.0-8.1998, FDH-29411.

---

### **Anton (Mark) Pertunaj**

(25.04.1969, shqiptar nga Ranoci/Renovac, komuna e Klinës/Klina, punëtor, tre fëmijë)

Nga mesi i qershorit të vitit 1998, Antoni aderoi në UÇK. Ditën e kalonte me familje në shtëpi, ndërsa natën shkante në detyrë. Në datën **27.07.1998**, nga ora 17:00, pranë shtëpisë së Antonit [**Ranoci/Renovac**] u ndal një automobil i tipit *Jugo*, të ngjyrës së bardhë. Nga ai dolën disa burra të panjohur dhe të veshur në rroba civile. E thirrën Antonin në gjuhën shqipe. Ai doli nga shtëpia dhe ata e morën me vete duke e çuar në drejtim të panjohur. Nga ajo ditë, për Antonin nuk ka asnjë gjurmë. Për fatin e tij nuk dihet asgjë as sot. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është i evidentuar në lëndën që e mban numrin YUK-050130-01.

**Burimet:** deklarata T.P, FDH-15578; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

---

### **Balë (Beqir) Balaj**

(20.12.1947, shqiptar nga Gllareva/Iglarevo, komuna e Klinës/Klina, punëtor, tetë fëmijë)

Balë Balaj ka punuar në Kroaci përpara luftës. Pas daljes në pension si invalid, ai u kthye në Gllarevë/Iglarevo. Në kohën e fillimit të konfliktit në Kosovë, gjendja e tij shëndetësore u përkeqësua. Në fillim të muajit qershor të vitit 1998, familja e tij e ka braktisur fshatin, ndërkaq ai ka mbetur në shtëpi. Ka gjetur vdekjen më **28.07.1998**, nga eksplozimi i granatës në një pyll afër **Gllarevës/Iglarevo**, ku ishte strehuar kur forcat serbe e sulmuan fshatin. E kanë varrosur po atë ditë afër vendit ku kishte pësuar. Edhe sot prehet në atë vend.

**Burimi:** deklarata F.B, FDH-16490.

---

### **Alush (Zeqir) Berisha**

(5.04.1956, shqiptar nga Gjurgjeviku i Madh/Veliki Đurdevik, komuna e Klinës/Klina, bujk, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Alushi aderoi në radhët e UÇK-së në vitin 1997. Kur, më **28.07.1998**, forcat serbe i sulmuan pozicionet e UÇK-së në **Gjurgjevikun e Madh/Veliki Đurdevik** dhe fshatrat përreth, Alushi me bashkëluftëtarë u tërhoqën në pyll përmbi lagjen e *Vuçakut/Vučak*. Po atë ditë, Alushi ka rënë në betejë me forcat serbe. Bashkëluftëtarët e kanë bartur trupin e tij të pajetë në fshatin Likoc/Likovac [Skënderaj/Srbica]. Në orët e vona të mbrëmjes, vëllai i Alushit, Ahmeti, e ka çuar trupin e Alushit në Rezallë/Rezale [Skënderaj/Srbica]. Alushin e kanë varrosur në të njëjtën mbrëmje në varrezat e këtij fshati. Mbetjet e tij mortore janë rivarrosur në vitin 2000 në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Grabanicë/Grabanica [Klinë/Klina], në vendin e quajtur *Kodra e kuqe/Crveni breg*.

**Burimet:** deklarata A.B, FDH-30780; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

---

### **Rexhep (Tafil) Shala**

(5.11.1937, shqiptar nga Gjurgjeviku i Madh/Veliki Đurdevik, komuna e Klinës/Klina, bujk, tetë fëmijë)

### **Murat (Mehmet) Raci**

(1.02.1945, shqiptar nga Gjurgjeviku i Madh/Veliki Đurdevik, komuna e Klinës/Klina, llogaritar, njëmbëdhjetë fëmijë)

Rexhepi merrej me bujqësi, ndërkaq Murati punonte në shërbimet administrative të Qendrës Mjekësore në Klinë/Klina. Kur pjesëtarë të forcave serbe i sulmuan fshatrat përreth më 14.07.1998, gratë dhe fëmijët e tyre u strehuan në fshatin Vuçak/Vuçak [Gllagoc/Glogovac]. Rexhepi dhe Murati ndenjen me burra të tjerë në fshat. Pjesëtarë të forcave serbe e sulmuan Gjurgjevikun e Madh/Veliki Đurdevik më **1.08.1998**. Që të gjithë burrat, përpos Rexhepit, e braktisën fshatin dhe u nisën për në Vuçak/Vuçak te familjet e veta. Fillimisht, Murati u nis me burrat e fshatit por, pas pak, ndërroi mendjen dhe u kthye në **Gjurgjevikun e Madh/Veliki Đurdevik**. Nga ajo ditë, askush nuk i kishte takuar më Muratin dhe Rexhepin. Në datën 5.08.1998, në fshat u kthyen djali i Rexhepit, Ferizi, vëllezërit Hasani, Istrefi,